



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËS
DHE ENERGJISË

Nr. 5383 / prot.

Tiranë, më 24.3.2018

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1654, datë 12.08.2013.

SHOQËRISË "IMPERIAL CONSTRUCTION PLUS" SH.P.K
Lagjia "15 Tetori", Rruga "Xox Andoni", Nr.10, Fier.

Për dijeni: **AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE**
Bulevardi "Bajram Curri", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë.

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE
EMERGJENCAT NË MINIERA (AKSEM), ISH RISHM**
Rruga "Lord Bajron", Laprakë, Tiranë.

Shoqëria "Imperial Construction Plus" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1654, datë 12.08.2013, për mineral harchburgit, në objektin "Bratile", Gramsh, Qarku Elbasan.

Me shkresën e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) nr.4754, datë 14.06.2016, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.4047, datë 15.06.2016, me shkresën nr.5804, datë 07.07.2017, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.5383, datë 01.08.2017, është propozuar revokimi i lejes nr.1654, datë 12.08.2013, për mineral harchburgit, në objektin "Bratile", Gramsh, Qarku Elbasan, sepse nuk ka paguar garancinë financiare të rehabilitimit të mjedisit në shumën totale 387000 lekë, siç është përcaktuar në nenin 31, pika 5, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për vitet 2014 – 2015 dhe 2015-2016, 2016-2017.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, për revokim, është i mbështetur në germen "ç", të pikës 1, të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1654, datë**

12.08.2013, për mineral harchburgit, në objektin "Bratë", Gramsh, Qarku Elbasan, që shoqëria juaj zotëron.

Ju vëmë në dijeni se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.1654, datë 12.08.2013, për mineral harchburgit, në objektin "Bratë", Gramsh, Qarku Elbasan.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI
DAMIAN GJIKNURI

NË MUNGESË DHE ME POROSI

ZËVENDËSMINISTRI

ENIS ALIKO

